



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/834

Datë: 31/7/2023

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", shpallë:

**KONKURS PLOTËSUES**

***për plotësimin e vendeve të lira nga konkursi për pranimin e studentëve në studimet themelore  
- bachelor në vitin akademik 2023/24***

**I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në vitin e parë të studimeve themelore - bachelor, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2023/2024, do të regjistrojë **2711** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI, universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri **659** studentë të rregullt nga komuniteti jo shumicë. Kuota prej **12%** e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve, mund të pranohen deri në **2%**, përkatësisht deri në **95** kandidatë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, deri në **2%**, përkatësisht deri në **108** kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Republika e Shqipërisë dhe deri në **1%**, përkatësisht deri në **56** kandidatë nga Mali i Zi. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërhënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
4. Përgjithshëm kushteve të veçanta, të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. Universiteti i Prishtinës, mbi bazën e konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e aplikimit do t'ua shtoj nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.
6. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
8. Në universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
9. Kandidatë jo kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe që nuk kanë nënshtetësi Kosovare.

10. Dëshmia për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ndërsa barasvlera e notave do të bëhet nga Zyra për Zhvillim Akademik, e cila gjendet në Fakultetin Filozofik, kati II, nr. 107.
11. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën, në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram, përveç në rastet specifike, ku testi do të përgatitet në gjuhën, në të cilën zhvillohet programi (p.sh. në programet e Fakultetit të Filologjisë: Gjuhë dhe Letërsi Angleze; Gjuhë dhe Letërsi Gjermane; Gjuhë dhe Letërsi Frënge; Gjuhët dhe Letërsi Turke dhe Orientalistikë).
12. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik, duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. **Deklarimi i rrejtshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, konsiderohet vepër penale. Kandidati/ja që mbi bazën e deklaramit të rrejtshëm, apo dokumentacionit të falsifikuar ka arritur të pranohet në mënyrë të padrejtë në Universitetin e Prishtinës, do të përjashtohet në mënyrë automatike nga Universiteti i Prishtinës, në momentin e vërtetimit të një fakti të tillë.**
14. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UP pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
15. **Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2023/24 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se një fakultet, departament, drejtim apo program.**

## II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. **Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:**
  - a) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:**

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë dhe atë:

    - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë dhe
    - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
  - b) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë dhe atë:

    - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
    - Suksesi në maturë deri në 30 pikë dhe
    - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. **Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues, deri në numrin e paraparë sipas konkursit.**
3. **Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**
4. **Përfundimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kritereve të përcaktuara si në paragrafët 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
5. **Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.**
6. **Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.**
7. **Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve që kanë konkurruar t'ia dërgojnë rektoratit të universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e fakultetit.**
8. **Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimit ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 10 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.**
9. **Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtij prioriteti:**
  - a) **Kandidati/ja i/ cili/a ka rezultat më të mirë të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta;**
  - b) **Kandidati/ja i/ cili/a ka sukses më të mirë të shkollës së mesme, e nëse edhe pikët e provimit pranues dhe të suksesit të shkollës së mesme janë të njëjta;**
  - c) **Kandidati/ja i/ cili/a ka rezultat më të mirë nga testi i maturës.**
  - d) **Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përzgjedhja e kandidatit/es fitues, do të bëhet përmes tërheqjes së shorti në prani të kandidatëve me pikë të barabarta si në paragrafët a), b) dhe c) të pikës 9.**
10. **Në rast se mbesin vende të lira në kategorinë si në paragrafin 2 dhe 3 të pikës II, atëherë plotësimi i vendeve që i takojnë kësaj kategorie do të bëhet sipas ranglistës së pikëve, me kandidatë që e kanë kaluar pragun e kalueshmërisë në afatin e parë të konkursit dhe që i takojnë komunitetit jo shumicë. Nëse nga afati i parë nuk ka kandidatë në listën e pritjes për arsye të mos arritjes së pragut minimal të kalueshmërisë, plotësimi i vendeve të lira do të bëhet sipas ranglistës së pikëve, me kandidatë që kanë kaluar pragun e kalueshmërisë në afatin e dytë (II).**

### III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> hapet prej datës **31.8.2023** deri më datë **7.9.2023** në orën 16.00. Gjatë kësaj periudhe do të bëhet edhe dorëzimi i dokumentacionit fizik nga kandidatët. Dokumentacioni do të pranohet çdo ditë pune.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **31.8.2023**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **9:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **31.8.2023** deri më datën **7.9.2023**. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula e noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim fizik është si në vijim:**
  - a) *Ekstrakti i lindjes (origjinal) jo më i vjetër se 6 muaj;*
  - b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinale, dublikatë ose të noterizuara);*
  - c) *Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (origjinale, dublikatë ose e noterizuar);*
  - d) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinale, dublikatë ose e noterizuar);*
  - e) *Kopjen e letërnjoftimit;*
  - f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>;*
  - g) *Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. Lista e institucioneve parauniversitare të licencuara në vend, sigurohet në MASHTI nga Administrata Qendrore e UP-së (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).*
6. Me rastin e aplikimit në datat e caktuara si në pikën 3 të kapitullit III, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 5 të këtij kapitulli, t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosje (fashikull) të bardhë, e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.
7. Nëse gjatë aplikimit online, kandidati gabimisht aplikon në një program tjetër studimor, atëherë duhet të kërkojë nga zyrtari i TI-së i fakultetit përkatës t'i fshihet aplikimi i gabuar nga sistemi në mënyrë që t'i mundësohet procedura e aplikimit nga fillimi. Kjo procedurë duhet të përfundojë para datës së mbylljes të aplikimit online.
8. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë për aplikim fizik, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati, pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.
9. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në uebfaqet e këtyre fakulteteve.
10. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të paraqitura si më poshtë:

#### Grupi I:

1. Fakulteti Filozofik, datë **11.9.2023**, në orën **9:00**;
2. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, datë **11.9.2023**, në orën **9:00**;
3. Fakulteti Juridik, datë **11.9.2023**, në orën **9:00**;
4. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, datë **11.9.2023**, fillon në orën **9:00-11:00**;
5. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës, datë **11.9.2023**, në orën **9:00**.
6. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, datë **11.9.2023** dhe **12.9.2023**, në ora **8:00**;
7. Fakulteti i Arkitekturës, datë **11.9.2023**, në ora **12:00.-17:00**;

## Grupi II:

1. Fakulteti i Filologjisë, datë **12.9.2023**, në orën **11:00**;
  2. Fakulteti Ekonomik, datë **12.9.2023**, në ora **9:00**;
  3. Fakulteti i Edukimit, datë **12.9.2023**, në ora **9:00**;
  4. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, datë **12.9.2023**, fillon në orën **13:00-15:00**;
  5. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, datë **12.9.2023**, fillon në ora **9:00-11:00**;
  6. Fakulteti i Mjekësisë, datë **12.9.2023**, duke filluar nga ora **15:00**;
  7. Fakulteti i Arteve, datë **11.9.2023** dhe **12.9.2023**, fillon në orën **9:00 me grupe**.
11. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të kenë me vete letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
12. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

## IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

1. **Shpallja e rezultateve preliminare** e provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë:
  - a) **Grupin i parë më së voni deri më datë 12.9.2023, në ora 16:00;**
  - b) **Grupin i dytë më së voni deri më datë 13.9.2023, në ora 16:00.**
2. *Rezultati preliminar nuk është rezultat përfundimtar. Me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, pasi me rastin e miratimit si të bazuar të ankesës, dikush nga kandidatët mund të radhitet me lart me pikë se kandidati i radhitur sipas rezultatit preliminar.*

## V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preliminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare** (llogaritet edhe dita e shtunë), respektivisht për grupet si në vijim:
  2. **Grupi i parë më së voni 15.9.2023, në ora 16:00;**
  3. **Grupi i dytë më së voni 18.9.2023, në ora 16:00.**
3. Pas afatit të përcaktuar si pikën e sipërshënuar ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet, menjëherë pas mbylljes së afati ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës.
4. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **15.9.2023-18.9.2023 (3 ditë pune)**.
5. Kandidatët të cilët kanë kaluar pragun e kalueshmërisë të përcaktuar si në Pjesën II (Mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve), paragrafi 3 dhe 4 të këtij konkursi, mirëpo për arsye se janë plotësuar të gjitha vendet e parapara në programin në të cilin kanë aplikuar, të njëjtit kanë ngelë jashtë listave të kandidatëve të pranuar, atëherë bazuar në ranglistën sipas pikëve të grumbulluara, të njëjtit mund të pranohen në programet studimore brenda njësisë akademike, në të cilat kanë mbetur vende të lira nga afati i parë i konkursit, me kusht që të kenë pasur testet e njëjta të provimit pranues.
6. Pranimi i kandidatëve si paragrafin 5 të kësaj pike do të bëhet vetëm pas shprehjes së interesimit për pranim në programin përkatës.
7. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

## VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. **Shpallja e rezultateve përfundimtare** të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse, pas shqyrtimit të ankesave sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë:
  - a) Grupin e parë më së voni deri më datë **18.9.2023**, pas orës **16:00**;
  - b) Grupin e dytë më së voni deri më datë **19.9.2023**, pas orës **16:00**.

## VII. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. **Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në Administratën Qendrore të UP-së (ndërtesa e Bibliotekës Universitare), sipas këtij orari:**
  - Fakulteti Filozofik, datë **20.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Filologjisë, datë **20.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00 - 15:00**;
  - Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, datë **20.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, datë **20.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Ndërtimtarisë, datë **20.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00 - 15:00**;
  - Fakulteti i Arkitekturës, datë **21.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00 - 15:00**;
  - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, datë **21.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti Ekonomik, datë **21.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Edukimit, datë **21.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Arteve, datë **21.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, datë **22.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti Juridik, datë **22.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Mjekësisë, datë **22.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, **22.9.2023**, prej orës **9:00-12:00** dhe **13:00-15:00**.
2. **Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **05.10.2022**, në orën **15:00**. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së Sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.**
3. Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar, nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
4. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
  - a) Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili shkarkohet dhe shtypet (bardh e zi) nga faqja <http://apliko.uni-pr.edu>
  - b) Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
  - c) Sipas UA (MASHTI) Nr. 09/2021, të gjithë studentët që fillojnë studimet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" lirohen nga pagesa e tarifës së shkollimit kur e regjistrojnë semestrin për herë të parë.

## I. FAKULTETI FILOZOFIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **352** studentë në departamentet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi  | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|--|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Filozofik</b>   | 256                      | 70  | 9  | 12   | 5                           | 352      |
| <b>Departamenti Filozofi</b>   | 71                       | 12  | 2  | 2  | 1                           | 88       |
| Programi Filozofi  | 71                       | 12  | 2  | 2  | 1                           | 88       |
| <b>Departamenti Punë Sociale</b>   | 0                        | 6   | 0  | 1  | 0                           | 7        |
| Programi Punë Sociale  | 0                        | 6   | 0  | 1  | 0                           | 7        |
| <b>Departamenti Histori</b>  | 61                       | 12  | 2  | 2  | 1                           | 78       |
| Programi Histori   | 61                       | 12  | 2  | 2  | 1                           | 78       |
| <b>Departamenti Shkenca Politike</b>   | 41                       | 12  | 2  | 2  | 1                           | 58       |
| Programi Shkenca Politike:<br>a) Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci;<br>b) Administrim publik | 41                       | 12  | 2  | 2  | 1                           | 58       |
| <b>Departamenti Sociologji</b>   | 36                       | 11  | 2  | 2  | 0                           | 51       |
| Programi Sociologji  | 36                       | 11  | 2  | 2  | 0                           | 51       |
| <b>Departamenti Psikologji</b>   | 0                        | 9   | 0  | 2  | 1                           | 12       |
| Programi Psikologji  | 0                        | 9   | 0  | 2  | 1                           | 12       |
| <b>Departamenti Antropologji</b>   | 47                       | 8   | 1  | 1  | 1                           | 58       |
| Programi Antropologji dhe Trashëgimi Kulturore   | 47                       | 8   | 1  | 1  | 1                           | 58       |

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Punës Sociale nga Edukata Qytetare, Psikologjia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Historisë nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Shkencave Politike nga Sociologjia, Filozofia, Historia dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Sociologjisë nga Sociologjia dhe Filozofia;
- Në Departamentin e Psikologjisë nga Psikologjia, Filozofia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime;
- Në Departamentin Antropologji dhe Trashëgimi Kulturore nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia.

## II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **361** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi   | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|-----------------------------------|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>SHMN</b>                       | 267                      | 66  | 10   | 10   | 8                           | 361      |
| <b>Departamenti i Matematikës</b> | 61                       | 19  | 3  | 3  | 2                           | 88       |
| Programi Matematikë               | 31                       | 7   | 1  | 1  | 1                           | 41       |
| Programi Shkencat Kompjuterike    | 0                        | 7   | 1  | 1  | 1                           | 10       |

|  |           |           |          |          |          |           |
|--|-----------|-----------|----------|----------|----------|-----------|
| Programi Matematikë financiare në banka dhe sigurime | 30        | 5         | 1        | 1        | 0        | 37        |
| <b>Departamenti i Fizikës</b>                        | <b>42</b> | <b>7</b>  | <b>1</b> | <b>1</b> | <b>1</b> | <b>52</b> |
| Programi Fizikë                                      | 42        | 7         | 1        | 1        | 1        | 52        |
| <b>Departamenti i Kimisë</b>                         | <b>62</b> | <b>14</b> | <b>2</b> | <b>2</b> | <b>2</b> | <b>82</b> |
| Programi Kimi  | 29        | 7         | 1        | 1        | 1        | 39        |
| Programi Kimi Inxhinierike                           | 33        | 7         | 1        | 1        | 1        | 43        |
| <b>Departamenti i Biologjisë</b>                     | <b>65</b> | <b>18</b> | <b>3</b> | <b>3</b> | <b>2</b> | <b>91</b> |
| Programi Biologji                                    | 22        | 7         | 1        | 1        | 1        | 32        |
| Programi Ekologji - Mbrojtje e mjedisit              | 36        | 7         | 1        | 1        | 1        | 46        |
| Programi Biologji Molekulare                         | 7         | 4         | 1        | 1        | 0        | 13        |
| <b>Departamenti i Gjeografisë</b>                    | <b>37</b> | <b>8</b>  | <b>1</b> | <b>1</b> | <b>1</b> | <b>48</b> |
| Programi Gjeografi                                   | 37        | 8         | 1        | 1        | 1        | 48        |

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës nga Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Kimisë nga Kimia, Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë nga Gjeografia.

Në testet e provimit pranues të cilat kanë detyra, krahas qarkimit të përgjigjes së saktë, duhet të ofrohet edhe zgjidhja e detyrës.

### III. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **248** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi     | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej   |
|-------------------------------------|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|------------|
| <b>Filologjik</b>                   | <b>158</b>               | <b>65</b>                                 | <b>10</b>                                      | <b>10</b>  | <b>5</b>                    | <b>248</b> |
| Programi Gjuhë Shqipe               | 30                       | 7   | 1  | 1  | 1                           | 40         |
| Programi Letërsi Shqipe             | 45                       | 7   | 1  | 1  | 0                           | 54         |
| Programi Gjuhë dhe Letërsi Angleze  | 0                        | 13  | 1  | 1  | 1                           | 16         |
| Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane | 0                        | 14  | 2  | 2  | 1                           | 19         |
| Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge   | 32                       | 6   | 1  | 1  | 1                           | 41         |
| Programi Orientalistikë             | 14                       | 4   | 1  | 1  | 0                           | 20         |
| Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke    | 14                       | 4   | 1  | 1  | 0                           | 20         |
| Programi Gazetari                   | 0                        | 10  | 2  | 2  | 1                           | 15         |
| Programi Ballkanistikë              | 23                       | 0   | 0  | 0  | 0                           | 23         |

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të departamentit përkatës të fakultetit:

- Në Programin e Gjuhës Shqipe nga Gjuha shqipe (me shkrim);



- Në Programin e Letërsisë Shqipe nga Letërsia shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze nga Gjuha angleze (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane nga Gjuha gjermane (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge nga Gjuha frënge (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Turke nga Gjuha turke (me shkrim);
- Në Programin e Orientalistikës provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë turke dhe arabe (njohuri elementare), Qytetërim islam, kulturë orientale (me shkrim);
- Në Programin e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Qytetërim shqiptar, Qytetërim botëror, dhe Ese.
- Provimi pranues në Ballkanistikë mbahet me shkrim nga gjuha amtare e kandidatit/es dhe nga gjuha ballkanike, për t'u përcaktuar saktë niveli gjuhësor i kandidatit/es.

Për kandidatët shqiptarë, gjuhë ballkanike është njëra nga gjuhët: BSKM (boshnjake, serbe, kroate, malazeze), maqedone, bullgare, greke, rumune ose turke, ndërkaq për kandidatët joshqiptarë, gjuhë ballkanike në këtë program është gjuha shqipe.

#### **IV. FAKULTETI JURIDIK**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **216** studentë të rregullt.

| Fakulteti/Departamenti/Programi | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|---------------------------------|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Juridik</b>                  | 117                      | 70  | 11   | 12   | 6                           | 216      |

#### **PROVIMI PRANUES**

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së Drejtës, E Drejta Kushtetuese dhe Gjuhë Shqipe.

#### **V. FAKULTETI EKONOMIK**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **586** studentë të rregullt, dhe atë në departamentet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi       | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|---------------------------------------|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Ekonomik</b>                       | 408                      | 130                                       | 17   | 21   | 10                          | 586      |
| <b>Departamenti Banka dhe financa</b> | 142                      | 36  | 5  | 6  | 2                           | 191      |
| Programi Banka dhe financa            | 142                      | 36  | 5  | 6  | 2                           | 191      |
| <b>Departamenti Menaxhment</b>        | 1                        | 16  | 1  | 3  | 1                           | 22       |
| Programi Menaxhment                   | 1                        | 16  | 1  | 3  | 1                           | 22       |
| <b>Departamenti Marketing</b>         | 65                       | 24  | 3  | 4  | 2                           | 98       |
| Programi Marketing                    | 65                       | 24  | 3  | 4  | 2                           | 98       |
| <b>Departamenti Ekonomiks</b>         | 93                       | 18  | 3  | 2  | 2                           | 118      |
| Programi Ekonomiks                    | 93                       | 18  | 3  | 2  | 2                           | 118      |
| <b>Departamenti i Kontabilitetit</b>  | 88                       | 30  | 5  | 5  | 2                           | 130      |
| Programi i Kontabilitetit             | 88                       | 30  | 5  | 5  | 2                           | 130      |

|  |    |   |   |   |   |    |
|--|----|---|---|---|---|----|
| Departamenti Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment (Gjuhë Angleze) (BSc) | 19 | 6 | 0 | 1 | 1 | 27 |
| Programi Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment (Gjuhë Angleze) (BSc)     | 19 | 6 | 0 | 1 | 1 | 27 |

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për departamentet në gjuhën shqipe do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi dhe Matematikë. Provimi pranues për programin Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment (Gjuhë Angleze)(BSc), do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi, Matematikë dhe Gjuhë angleze.

### VI. FAKULTETI I NDËRTIMTARISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **210** studentë të rregullt dhe atë sipas departamenteve si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi                 | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|---|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit</b>    | 162                      | 36  | 5  | 5  | 2                           | 210      |
| <b>Departamenti i Konstruksioneve</b>           | 72                       | 18  | 2  | 3  | 0                           | 95       |
| Programi Konstruktiv                            | 72                       | 18  | 2  | 3  | 0                           | 95       |
| <b>Departamenti i Hidroteknikës</b>             | 44                       | 7   | 1  | 1  | 1                           | 54       |
| Programi Hidroteknikë                           | 44                       | 7   | 1  | 1  | 1                           | 54       |
| <b>Departamenti i Gjeodezisë</b>                | 21                       | 6   | 1  | 0  | 1                           | 29       |
| Programi Gjeodezi                               | 21                       | 6   | 1  | 0  | 1                           | 29       |
| <b>Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit</b> | 25                       | 5   | 1  | 1  | 0                           | 32       |
| Programi Inxhinieri e Ambientit                 | 25                       | 5   | 1  | 1  | 0                           | 32       |

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimum 40% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë së kandidatëve të cilët aplikojnë në kuadër të kuotave të veçanta, të cilët duhet të arrijnë minimum 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

### VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **61** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi                   | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|---|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>FIEK</b>                                       | 1                        | 46  | 4  | 6  | 4                           | 61       |
| Programi Inxhinierisë Kompjuterike dhe Softuerike | 1                        | 15  | 2  | 2  | 1                           | 21       |
| Programi Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë     | 0                        | 14  | 1  | 2  | 1                           | 18       |

|   |   |    |   |   |   |    |
|---|---|----|---|---|---|----|
| Programi Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit | 0 | 10 | 0 | 2 | 1 | 13 |
| Programi Elektroenergjetikë                           | 0 | 7  | 1 | 0 | 1 | 9  |

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha programet do të mbahet nga lënda: Matematikë.

### VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **276** studentë të rregullt dhe atë sipas programeve si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi                               | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej   |
|---|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|------------|
| <b>Fakulteti i i Inxhinierisë Mekanike</b>                    | <b>206</b>               | <b>48</b>                                 | <b>9</b>                                       | <b>8</b>   | <b>5</b>                    | <b>276</b> |
| Programi Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment | 38                       | 9   | 2  | 2  | 1                           | 52         |
| Programi Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme        | 40                       | 11  | 2  | 2  | 1                           | 56         |
| Programi Komunikacion dhe transport                           | 43                       | 9   | 2  | 2  | 1                           | 57         |
| Programi Mekatronikë  | 35                       | 11  | 2  | 1  | 1                           | 50         |
| Programi Dizajn Inxhinierik dhe automjete                     | 50                       | 8   | 1  | 1  | 1                           | 61         |

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha programet do të mbahet nga lënda: Matematikë.

### IX. FAKULTETI I MJEKËSISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **63** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej  |
|---------------------------------|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|-----------|
| <b>Fakulteti i Mjekësisë</b>    | <b>14</b>                | <b>34</b>                                 | <b>5</b>                                       | <b>6</b>   | <b>4</b>                    | <b>63</b> |
| Programi Mjekësi e Përgjithshme | 0                        | 12  | 4  | 2  | 1                           | 19        |
| Programi Stomatologji           | 0                        | 6   | 0  | 1  | 1                           | 8         |
| Programi Farmaci                | 14                       | 6   | 1  | 1  | 1                           | 23        |
| Programi Infermieri             | 0                        | 10  | 0  | 2  | 1                           | 13        |

Kandidatët të cilët aplikojnë për programin e studimit Infermieri duhet të kenë të kryer shkollën e mesme të Mjekësisë.

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha programet e Fakultetit të Mjekësisë mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

## X. FAKULTETI I ARTEVE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **71** të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi                 | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|---|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Arteve të Bukura</b>                         | 48                       | 17  | 2  | 4  | 0                           | 71       |
| <i>Departamenti i Arteve të Bukura</i>          | 12                       | 4   | 1  | 0  | 0                           | 17       |
| <i>Programi Bachelor i Arteve Vizuele</i>       | 12                       | 4   | 1  | 0  | 0                           | 17       |
| Profili Pikturë                                 | 0                        | 1   | 1  | 0  | 0                           | 2        |
| Profili Skulpturë                               | 5                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 5        |
| Profili Grafikë                                 | 1                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 2        |
| Profili Arti konceptual dhe mediet e reja       | 6                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 6        |
| Profili Dizajn i inovacioneve                   | 0                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 1        |
| Profili Dizajn i komunikimit                    | 0                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 1        |
| Profili Ilustrim dhe vizatim                    | 0                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 0        |
| <b>Departamenti i Artit Muzikor</b>             | 22                       | 9   | 1  | 1  | 0                           | 33       |
| <i>Programi Bachelor i Muzikës</i>              | 2                        | 2   | 1  | 1  | 0                           | 6        |
| Profili Pedagogji e përgjithshme muzikore       | 0                        | 2   | 1  | 1  | 0                           | 4        |
| Profili Kompozim                                | 2                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 2        |
| <b>Programi Bachelor i Muzikës në Performim</b> | 20                       | 7   | 0  | 0  | 0                           | 27       |
| Profili Solo këndim                             | 0                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 0        |
| Profili Dirigjim                                | 1                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 1        |
| Profili Piano                                   | 2                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 3        |
| <b>Profili Instrumente me harqe dhe tela</b>    | 7                        | 2   | 0  | 0  | 0                           | 9        |
| Moduli Violinë                                  | 1                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 1        |
| Moduli Violë                                    | 1                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 2        |
| Moduli Violonçelo                               | 1                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 2        |
| Moduli Kontrabas                                | 2                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 2        |
| Moduli Kitarë                                   | 2                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 2        |
| <b>Profili Instrumentet frymore</b>             | 10                       | 4   | 0  | 0  | 0                           | 14       |
| Moduli Flaut                                    | 4                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 5        |
| Moduli Obo                                      | 1                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 1        |
| Moduli Klarinetë                                | 1                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 2        |
| Moduli Trombon                                  | 0                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 0        |
| Moduli Fagot                                    | 1                        | 0   | 0  | 0  | 0                           | 1        |
| Moduli Korne                                    | 1                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 2        |
| Moduli Trompete                                 | 1                        | 1   | 0  | 0  | 0                           | 2        |

|  |           |          |          |          |          |           |
|--|-----------|----------|----------|----------|----------|-----------|
| Moduli Saksofon                        | 0         | 0        | 0        | 0        | 0        | 0         |
| Moduli Tubë                            | 1         | 0        | 0        | 0        | 0        | 1         |
| <b>Departamenti i Arteve Dramatike</b> | <b>14</b> | <b>4</b> | <b>0</b> | <b>3</b> | <b>0</b> | <b>21</b> |
| <b>Programi i Arteve Dramatike</b>     | <b>14</b> | <b>4</b> | <b>0</b> | <b>3</b> | <b>0</b> | <b>21</b> |
| Profili Aktrim                         | 1         | 1        | 0        | 0        | 0        | 2         |
| Profili Dramaturgjii dhe Skenar filmi  | 2         | 0        | 0        | 1        | 0        | 3         |
| Profili Regji Filmi dhe Televizioni    | 1         | 0        | 0        | 0        | 0        | 1         |
| Profili Regji Teatri                   | 2         | 1        | 0        | 0        | 0        | 3         |
| Profili Dizajn Skene dhe Kostumografi  | 2         | 0        | 0        | 0        | 0        | 2         |
| Profili Kamerë dhe Montazhë            | 3         | 1        | 0        | 1        | 0        | 5         |
| Profili Produksion                     | 3         | 1        | 0        | 1        | 0        | 5         |

## KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

### NË DEPARTAMENTET E ARTEVE TË BUKURA:

#### Profili: Pikturë

##### *Faza e parë*

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

##### *Faza e dytë*

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e pikturës përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

##### *Faza e tretë*

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën dizajni@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, piktura dhe skica ideore).

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

**Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete një kanavacë të formatit 50x70cm, një pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit dhe ngjyrat sipas dëshirës.**

#### Profili: Skulpturë

##### *Faza e parë*

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

##### *Faza e dytë*

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e skulpturës përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

##### *Faza e tretë*

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën dizajni@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, piktura dhe skica ideore).

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

**Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete një pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit.**

#### Profili: Grafikë

##### *Faza e parë*

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

#### **Faza e dytë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e grafikës duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

#### **Faza e tretë**

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën dizajni@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, piktura dhe skica ideore).  
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.  
**Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete dy pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit dhe ngjyrat e tushit.**

#### **Profili: Arti konceptual dhe mediat e reja**

##### **Faza e parë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e artit konceptual dhe mediave të reja përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

##### **Faza e dytë**

- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

##### **Faza e tretë**

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën dizajni@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e mediave të reja në të cilat mund të përfshijnë (fotografi, video, instalacione, intervenime artistike apo skica ideore).  
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.  
**Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete, një pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit dhe ngjyrat sipas dëshirës.**

#### **Profili: Dizajn i inovacioneve**

##### **Faza e parë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e dizajnit dhe inovacioneve duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike nga fusha e dizajnit të produkteve, dizajnit të modës, marketingut në rrjete sociale dhe fotografisë.
- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike

##### **Faza e dytë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit në softuerët e Adobe Suite përmes realizimit të një detyre kreative.

##### **Faza e tretë**

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën dizajni@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e Dizajnit në të cilat mund të përfshijnë (dizjane të produkteve, dizajne të modës, animacione, fotografi, poster dhe punime të tjera kreative).  
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

#### **Profili: Dizajn i komunikimit**

##### **Faza e parë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e dizajnit duke realizuar një detyre kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike në fushën e ilustrimit, mediave dixhitale dhe komunikimit vizual.
- Kandidatët duhet të shkruajnë një ese prej 400 fjalësh, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

##### **Faza e dytë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit në softuerët e Adobe Suite përmes realizimit të një detyre kreative.

##### **Faza e tretë**

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën dizajni@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e Dizajnit në të cilat mund të përfshijnë (ilustrime, skica ideore, dizajn të web-faqes, video dhe punime të tjera kreative).  
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

## **Profili: Ilustrim dhe vizatim**

### **Faza e parë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

### **Faza e dytë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e ilustrimit duke realizuar një detyrë kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

### **Faza e tretë**

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën dizajni@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e arteve vizuale në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, ilustrime dhe skica ideore).  
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.  
**Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete një kanavacë të formatit 50x70cm, një pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit dhe ngjyrat sipas dëshirës.**

## **NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE MUZIKORE:**

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në nivelin baçelor në Fakultetin e Arteve, respektivisht në profilet e Departamentit të Muzikës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

Duhet të ketë të përfunduar shkollën e mesme të Muzikës në instrumentin përkatës apo drejtimin përkatës.

## **BACHELOR I MUZIKËS NË PERFORMIM**

### **Profili: Piano**

- Provim nga lënda PIANO - a) J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga WTC; b) 1 Vepër virtuoze; c) 1 Sonatë klasike (një kohë); d) 1 Vepër madhore romantike;
- Provim nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lënda TEORI E MUZIKËS.

### **Profili: Instrumentet me harqe dhe tela**

- Provim nga instrumenti harkor përkatës - a) J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita; b) 1 Koncert (një kohë); c) 1 Sonatë (një kohë); d) 1 Pjesë cantilene;
- **Moduli: KITARË** - a) 2 kohë nga suitat e Bach-ut (nga suitat për çello ose flaut); b) F. SOR – 1 etydë nga op. 6. dhe 29; c) 1 etydë përzgjedhje; d) 1 vepër ciklike;
- Provim nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS.

### **Profili: Instrumentet frymore**

- Provim nga lënda e instrumenti frymor përkatës - a) 1 Koncert (komplet); b) 1 Sonatë (komplet); c) 1 Pjesë virtuoze;
- Provimi nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS.

### **Profili: Solo këndim**

- Provim nga lënda: SOLO KËNDIM - a) 2 Arie (nga repertori operistik); b) 2 Këngë solo (në cilëndo gjuhë);
- Provim nga lëndët: SOLFEZH - TEORI e MUZIKËS;
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT.

### **Profili: Dirigjim**

- Dirigjim i një vepre për ansambël kamertal, orkestër apo për ndonjë formacion koral; (dirigjimi mund të realizohet me korepetitor ose me incizim në DVD). Incizimi duhet të fokusohet në fytyrë (profil) dhe në lëvizjet e duarve të kandidatit, si dhe mundësisht edhe të një pjese të orkestrës. Incizimi duhet të dorëzohet së paku dy ditë para provimit;

- Provim nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lëndët: HARMONI;
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT.

## **BACHELOR I MUZIKËS**

### **Profili: Kompozim**

- Prezantimi i **3 kompozimeve** të dorëzuara;
- Provim nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lëndët: HARMONI – POLIFONI;
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT.

### **Profili: Pedagogji e përgjithshme muzikore**

- Provim nga lënda: SOLFEZH;
- Provim nga lënda: HARMONI;
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT.

## **NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE DRAMATIKE:**

### **Programi i Arteve Dramatike**

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

#### **Profili: Aktrim**

*Pjesa e parë* e programi eliminues:

- Recitim i një poezie (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Monolog dramaturgjia e autorëve- dramaturgëve botërorë dhe kombëtarë (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një këngë;
- Një imitim.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

*Pjesa e dytë* e programit eliminues:

- Puna me mësimdhënës të caktuar,
- Verifikimi përfundimtar i aftësive;
- Të gjithë aplikantët luten të sjellin fotografi “bust” në ditën e aplikimit.

#### **Profili: Regji Teatri**

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike.

Provim pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

#### **Profili: Regji Filmi dhe Televizioni**

Provim pranues është i ndarë në dy ditë dhe katër faza.

**Dita e parë:**

##### ***Faza e parë: Testi dhjetëpikësh***

Të gjithë kandidatët, që konkurojnë në Regji Filmi dhe Televizioni, do t'i nënshtrohen testit me dhjetë pyetje rreth njohurive të përgjithshme për filmin kombëtar dhe ndërkombëtar.



### **Faza e dytë: Shkrimi kreativ**

Të gjithë kandidatët, të cilët i nënshtrohen fazës së parë, kalojnë në fazën e dytë, ku secili prej tyre do të trajtojë me shkrim temën e dhënë nga komisioni. Detyra ka kërkesa teknike dhe kreative. Ana teknike e saj është kufizimi, në më së shumti dy faqe, dhe kreative, përmbajtja e tekstit, të dëshmojë se kandidati-ja posedon potencial kreativ artistik, që mund të zhvillohet përgjatë studimeve.

### **Faza e tretë: Intervista**

Të gjithë kandidatët, të cilët i nënshtrohen fazës së parë dhe të dytë, kalojnë në fazën e tretë.

Kjo fazë zhvillohet në formë të intervistës. Tani, komisioni ka lexuar dhe vlerësuar testin e parë, analizuar detyrën me shkrim dhe ka informacionin e nevojshëm për intervistim të secilit kandidat.

Komisioni komenton dy detyrat paraprake të kandidatës-it, shtron pyetje rreth kulturës, letërsisë, muzikës, dhe me theks të veçant kinematografisë.

Pas fazës së tretë, selektohen kandidatët me rezultatet më të mira nga fazat paraprake dhe kalojnë në fazën finale, e cila zhvillohet 24 orë më vonë.

### **Dita e dytë:**

#### **Faza e katërt: Filmi deri në tre minuta, pa montazh**

Në këtë fazë kalojnë vetëm kandidatët, të cilët komisioni i konsideron si më të mirët në fazat paraprake.

Të gjithë kandidatët, që kalojnë në këtë fazë, kanë detyrë që të xhirojnë një film në temën të cilën e kanë punuar me shkrim në fazën e dytë. Detyra është e thjeshtë. Kandidati-ja mund ta xhirojë filmin e tij/saj deri në tre minuta, pa e montuar fare. Ai/ajo bënë xhirimin e filmit në formë kronologjike, bazuar në rrefimin që ka shkruar në fazën e dytë.

Paisja për xhirim të filmit sigurohet nga vetë aplikanti. Paisja mund të jetë nga kamerat profesionale, deri në telefon të thjeshtë celular.

### **Profili: Dramaturgjia dhe skenar filmi**

Zvillimi i një skene dramatike përmes dialogut, me shkrim sipas një rrethane të caktuar.

Përmbledhje (sinopsis) i një ngjarje të mundshme për një skenar filmi.

Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga fusha e dramaturgjisë, kinematografisë dhe njohuri të përgjithshme.

### **Profili: Dizajn skene dhe Kostumografi**

#### **Faza e parë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e vizatimit duke realizuar portret, figurë sipas modelit përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

#### **Faza e dytë**

- Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohuritë e dizajnit të skenës dhe kostumeve duke realizuar një detyrë kreative përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

#### **Faza e tretë**

- Intervista dhe prezantimi i portofolios i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën dizajni@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e dizajnit të skenës dhe kostumeve në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, ilustrime, dizajne të skenës, dizajne të kostumeve dhe skica ideore).

Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.

**Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete një kanavacë të formatit 50x70cm, një pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit dhe ngjyrat sipas dëshirës.**

### **Profili: Produksion**

#### **Faza e parë**

- Kandidatët që konkurrojnë në profilin Produksion duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti, filmi, televizioni, radio dhe teatri.

#### **Faza e dytë**

- Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, do të nënshtrohen provimit, duke shkruar një koncept- ide të një projekti teator, filmik, televiziv, apo artistik.

#### **Faza e tretë**

- Kandidatët do të prezantojnë, mbrojnë projektin e tyre në fazën finale, në provim gojor, para komisionit.

### **Profili: Kamerë dhe Montazhë**

**Kontrolli i plotësisht të kriterëve për programin e studimit për kandidatët "Kamere dhe Montazh filmi" përbëhet nga dy pjesë:**

1. Në pjesën e parë, të gjithë kandidatët i nënshtrihen:
  - Bërja e një testi të kulturës së përgjithshme.
  - Një provim me shkrim - analizë (maksimum një faqe) e një filmi të shkurtër I cili prezantohet nga komisioni vlerësues para kandidatëve rreth kadrimit dhe montazhit.
  - Një provim gojor - një shtjellim i analizës me shkrim, si dhe pyetje nga fusha e Filmit, TV.
2. Pas pjesës së parë, bazuar në rezultatet, komisioni vendos drejt përzgjedhjes së kandidatëve në një listë të shkurtër, dhe kandidatët e përzgjedhur hyjnë në pjesën e dytë të procesit të përzgjedhjes:
  - Detyra praktike nga fusha e Kamerës dhe Montazhit të Filmit dhe TV, të prezantohet motivi me shkrim para komisionit, ide apo sinopsis në formë të shkruar jo më I gjatë se një faqe.
  - Pastaj kandidati duhet ta realizojë filmin jo më të gjatë se 3min, pra xhirohet dhe montohet, detyra pastaj vlerësohet nga komisioni vlerësues.
  - Një provim gojor ku kandidati do ta mbrojë punimin e tij para komisionit vlerësues, nga profili Kamerë dhe Montazh.

Bazuar në rezultatet nga pjesa e parë dhe e dytë të kontrollit, komisioni rendit dhe zgjedh kandidatët që kanë të drejtën të regjistrohen në profilin Kamerë dhe Montazh.

**Literatura për provim pranues: Aktrim, Regji Teatri, Regji Filmi, Dramaturgjia, Dizajn skene dhe Kostumografi, Produksion, Kamerë dhe Montazhë:**

- Georg Sodull: “Historia e filmit”
- Abaz Hoxha: “Historia e filmit shqiptar”
- Luis Herman: Skenari i filmit dhe i televizionit
- Jezhi Plazhevski: Gjuha e filmit
- Fadil Hysaj: “Teatrologji, dramaturgjia, regji dhe aktrim”
- Aristoteli: “Poetika”
- Vlladan Shvacov: “Bazat e dramaturgjisë”
- Dr. Nebi Islami: “Historia e dramës kombëtare 1886-1996”
- Dr. Josif Papagjoni: “Komedi që vjen nga skena”
- Eskili: “Orestia”
- Sofokli: Një tragjedi
- Aristofani: Një komedi
- Shekspiri: Një tragjedi
- Molieri: Një komedi
- Dramaturgjia nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
- Dramaturgjia bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasem Terbeshina etj.
- U. Gregor and E. Patalas: “History of Film”
- K. Raisz and G. Millar: “Film Editing”
- Marcel Martin: “The Language of Film”
- Jerzy Plazewski: “Jezik filma”
- Andre Bazin: “What is Cinema” (I, II, III, IV)

**XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **198** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi   | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|-----------------------------------|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Bujqësisë dhe Veterinarisë</b> | 142                      | 37  | 8  | 8  | 3                           | 198      |
| Programi Prodhimtaria bimore      | 9                        | 9   | 2  | 2  | 1                           | 23       |
| Programi Mjekësi Veterinare       | 11                       | 2   | 1  | 1  | 0                           | 15       |
| Programi Ekonomia e Bujqësisë     | 51                       | 10  | 2  | 2  | 1                           | 66       |

|  |    |    |   |   |   |    |
|--|----|----|---|---|---|----|
| Programi Teknologji ushqimore me bioteknologji | 53 | 12 | 2 | 2 | 1 | 70 |
| Programi Prodhim Shtazor                       | 18 | 4  | 1 | 1 | 0 | 24 |

### PROVIMI PRANUES

Në programin Mjekësi Veterinare, provimi pranues mbahet në lëndët: Kimi dhe Biologji, ndërsa për programet tjera, provimi mbahet në lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë.

## XII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **30** studentë të rregullt:

| Fakulteti/Departamenti/Programi    | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|------------------------------------|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Edukimi Fizik dhe i Sportit</b> | 14                       | 12  | 2  | 1  | 1                           | 30       |
| Meshkuj                            | 12                       | 8   | 1  | 0  | 1                           | 22       |
| Femra                              | 2                        | 4   | 1  | 1  | 0                           | 8        |

Kandidatët, para se të aplikojnë, duhet të sjellin nga 2 foto dhe dëshmi për kontroll të Gjendjes Psiko-Somatike (gjendja shëndetësore, të folurit, të shikuarit, të dëgjuarit, konstruksioni trupor). Kontrolli mjekësor bëhet në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive, në QKUK, pranë Stadionit "Ramiz Sadiku".

### PROVIMI PRANUES

Përmbajtja dhe mënyra e dhënies së provimit pranues është:

- Njohuritë lëvizore (motorike) sportive:
  - Futboll: puna me top-këmbë dhe kokë;
  - Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë;
  - Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh;
  - Volejbolli: pasimi i topit në çifte me gishtërinj dhe llëra (çekan), gjuajtja dhe pranimi i topit.
- Aftësitë lëvizore (motorike):
  - Kërcimi nga vendi në gjatësi;
  - Ngritja me forcë në hekur (meshkujt);
  - Përkulje mbi krah (femrat);
  - Shpejtësia në 100 m (matet koha e vrapimit- meshkujt dhe femrat);
  - Bashkërendimi (koordinimi lëvizor).
- Gjymnastikë sportive - Lëvizjet me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikalja mbi duar, kapërdimi para, rrotullimi anësor në të dy anët ose ylli (meshkujt dhe femrat).
- Not (demonstrim i një nga teknikat e notit)
- Agjilitet (T-testi)
- Test me shkrim (Ese e shkurtër deri 150 fjalë)

Kriteret e poentimit, janë sipas rregullores së brendshme mbi kriteret e veçanta në disiplinat përkatëse. Sportistët me rezultate të dalluara në sportet ndërkombëtare dhe ata në sportin kosovar poentohen edhe me pikë bonus, sipas kriteve të posaçme të rregullores së brendshme. Kandidatët janë të obliguar që në ditën e provimit pranues të kenë pajisjet sportive.

### XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **23** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi               | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|---|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Edukimit</b>                               | 0                        | 17  | 1  | 3  | 2                           | 23       |
| <b>Departamenti Edukimit Fillor</b>           | 0                        | 8   | 1  | 1  | 1                           | 11       |
| Programi Fillor                               | 0                        | 8   | 1  | 1  | 1                           | 11       |
| <b>Departamenti Edukimit Parashkollor</b>     | 0                        | 5   | 0  | 1  | 1                           | 7        |
| Programi Edukimi në Fëmijëri të Hershme (0-6) | 0                        | 5   | 0  | 1  | 1                           | 7        |
| <b>Departamenti i Pedagogjise</b>             | 0                        | 4   | 0  | 1  | 0                           | 5        |
| Programi Pedagogji e Përgjithshme             | 0                        | 4   | 0  | 1  | 0                           | 5        |

#### **PROVIMI PRANUES**

- **Programi Edukimi Fillor:** 1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike;
- **Programi Edukimi në Fëmijëri të Hershme:** 1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike;
- **Programi: Pedagogji e Përgjithshme:** 1. Gjuhë Shqipe, 2. Psikologji dhe shkathtësi analitike, 3. Edukatë Qytetare.

### XIV. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **16** studentë të rregullt dhe atë në departamentin si në vijim:

| Fakulteti/Departamenti/Programi | Për studime të rregullta | Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë, 12% | Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2% | Kandidatë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, 2% | Kandidatë nga Mali i Zi, 1% | Gjithsej |
|---------------------------------|--------------------------|---|--|--|-----------------------------|----------|
| <b>Fakulteti i Arkitekturës</b> | 0                        | 11  | 2  | 2  | 1                           | 16       |
| Programi Arkitekturë            | 0                        | 11  | 2  | 2  | 1                           | 16       |

#### **PROVIMI PRANUES**

Provimi pranues mbahet nga Matematika, Perceptimi i hapësirës dhe Vizatimi i lirë (sllajdi).

Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimum 40% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë së kandidatëve të cilët aplikojnë në kuadër të kuotave të veçanta, të cilët duhet të arrijnë minimum 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

